
favorshme për ushtrimin e biznesit, nga Banka;
"**Ecuria e Zakonshme e Veprimtarisë**" është veprimtaria ditore, në përputhje me praktikat e arsyeshme të drejtimit në sektorin bankar;
"**Personi**" është individi, shoqëria aksionare, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë e thjeshta, shoqata, fondacione, truste ose ente të tjera ose organizata, të cilat gëzojnë personalitet juridik, duke përfshirë çdo Autoritet Qeverisës;

"**Periudha Përpara Mbylljes**" është periudha nga Data e Nënshkrimit deri në Datën e Mbylljes, përfshirë këtë datë;

"**Çmimi i Blerjes**" do të ketë kuptimin që përcaktohet në nen-nenin 2.2.1;
"**Aksione**" do të ketë kuptimin që përcaktohet në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate;
"**Data e Nënshkrimit**" është data në të cilën kjo Kontratë nënshkruhet nga Blerësi dhe Shitësi, siç tregohet në faqen e parë të kësaj Kontrate;
"**Taksat**" ose "**Tatimet**" janë çdo formë detyrimi tatimor në Republikën e Shqipërisë, taksat, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera fiskale, duke përfshirë interesin, gjobat ose pagesa të ngjashme në lidhje me to, të pagueshme në favour të çdo autoriteti tatimor, doganor, fiskal, apo autoritet tjeter, ose të vendosura prej tyre;
"**Aksionet e Transaksionit**" ka kuptimin e percaktuar ne pjesen hyrese te kesaj Kontrate;

"**Garancitet**" janë deklarimet dhe garancite e dhëna nga Shitësi për Blerësin në Nenin 7.

1.2 Interpretimi

Në këtë Kontratë, me përjashtim të rastit kur konteksti e kërkon ndryshe:

(a) fjalët "në këtë Kontratë" " kësaj Kontrate", "prej kësaj Kontrate" dhe fjalë të përafërta i referohen kësaj Kontrate si e tërë dhe jo dispozitave të veçanta të kësaj Kontratë; dhe

(b) fjalët e përgjithshme të prezantuara nga fjalët dhe fjalitë të tilla si "përfshirë", "duke përfshirë", "tjetër" dhe "në veçanti" nuk kanë kuptim kufizues, ose që kufizojnë parimin e përgjithshëm të fjalëve, që paraprijnë ose që kufizohen sipas kategorisë të fjalëve që paraprijnë të cilat kanë interpretim më të gjerë.

2. TRANSFERIMI I AKSIONEVE

2.1 Shitja e Aksioneve

2.1.1 Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Shitësi do t'i shesë Blerësit Aksionet, të cilat Blerësi do t'i zotërojë plotësisht dhe Blerësi duhet të blejë nga Shitësi **Aksionet e Transaksionit**, të pangarkuara dhe të lira nga çdo Barrë apo kufizim.

2.1.2 Shitja e Aksioneve duhet të bëhet në Datën e Mbylljes, sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

2.1.3 Transferimi i Aksioneve duhet të bëhet në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme ne Shqiperi.

2.1.4 E drejta e pronësisë mbi Aksionet do t'i transferohet Blerësit në Mbyllje dhe Aksionet do të shiten dhe blihen së bashku me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që burojnë prej tyre në Mbyllje (duke përfshirë të drejtën për të marrë të gjitha dividendët apo çdo kthim të kapitalit të deklaruar, të paguar, ose që Banka ka bërë në Mbyllje ose pas saj).

2.2 Çmimi i Blerjes

2.2.1 Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Blerësi, në lidhje me shitjen, transferimin dhe dorëzimin e Aksioneve tek Blerësi, do t'i paguajë Shitësit shumën totale prej **266,133.00 USD** (Dyqind e gjashtedhjete e gjashte mije e njeqind e tridhjete e tre dollare amerikane) ("**Çmimi i Blerjes**"), per nje çmim prej 21.00 USD/- (njezet e një) per Aksion.

2.2.2 Çmimi i Blerjes do t'i paguhet Shitësit nëpërmjet transfertes kredituese ne fonde te pastra te disponueshme menjehere ne llogarine bankare te treguar nga Shitesi si vijon:

Monedha:	USD
Emri I Perfituesit:	Dallah AL Baraka Holding Company
Numri I Llogarise:	2010-201515-001
IBAN:	BH94 ABIB 0201 0201 5150 01
Kodi Swift:	ABIBBHBM
Banka Perfituese:	Al Baraka Islamic Bank
	Manama, Kingdom of Bahrain
Corresponding bank Name:	Standard Chartered Bank New York SCB NY
Account number:	3582025989001
Swift Code:	SCBLUS33

3. ZGJIDHJA E KONTRATËS PËRPARA MBYLLJES

3.1.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet përpara Mbylljes:

a) me marrëveshje të përbashkët te Palëve; ose

b) nga Pala që nuk është shkelëse e detyrimeve të saj, sipas përcaktimit të Nenit 6.3 (Mospërmbushja e Detyrimeve) të kësaj Kontrate; ose

c) nga secila Palë, duke njoftuar me shkrim Palën tjetër në adresën e treguar në Nenin 11 (Njoftimet), nëse Kushtet Paraprake nuk janë përmbushur, ose nga të cilat nuk është hequr dorë sipas Nenit 4 (Kushtet e Paraprake të Mbylljes); ose

d) në çdo kohë nga Shitësi, duke njoftuar me shkrim Blerësin, nëse Blerësi ka kryer shkelje thelbësore në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate; ose

e) në çdo kohë nga Blerësi, duke njoftuar me shkrim Shitësin, nëse Shitësi ka kryer shkelje thelbësore në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate (duke përfshirë shkelje të Garantimeve).

3.1.2 Kjo Kontrate mund te zgjidhet nga secila Pale me njoftim me shkrim te komunikuar Pales tjeter ne adresat e treguara ne nenin 11 (Njoftimet), nese regjistrimi i Bleresit si pronar i Aksioneve te Transaksionit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) dhe Qendren e Regjistrimit te Aksioneve (QRA) nuk eshte realizuar perpara ose ne Daten e Mbylljes.

3.1.3 Për qëllimet e Nenit 3, "**Shkelje Thelbësore**" është shkelja e Garantimeve dhe/ose angazhimeve të cilat kanë një ndryshim thelbësor të pafavorshëm në aftësinë e Bankës për të vazhduar veprimtarinë e saj në Rrjedhën e Zakonshme të Veprimtarisë së saj dhe/ose në reputacionin e Bankës.

3.1.4 Asgjë në këtë Nen 3 nuk shmang nga përgjegjësia për shkelje të kësaj Kontrate ndonjë nga Palët, të cilat janë kryer përpara zgjidhjes së Kontratës apo për shkelje të neneve që mbeten në fuqi pas zgjidhjes së kësaj Kontrate.

4. KUSHTET PARAPRAKE TË MBYLLJES

4.1.1 Detyrimet e Blerësit për të blerë Aksionet e Transaksionit sipas kësaj Kontrate janë objekt dhe kushtëzohen nga përmbushja e kushteve të mëposhtme paraprake ose nga heqja dorë prej tyre në Datën e Mbylljes ose përpara saj:

(a) të gjitha Garantimet do të jenë tërësisht të vërteta dhe korrekte në Datën e Nënshkrimit dhe Datën e Mbylljes, me të njëjtin efekt dhe fuqi sikur këto Garantime të ishin bërë në Datën e Mbylljes (me përjashtim të deklarimeve dhe garantimeve, të cilat trajtojnë çështje, që i përkasin një dite të veçantë, ose për një periudhë kohe të veçantë, të cilat duhet të jenë të sakta dhe të vërteta për këtë datë, ose për atë periudhë);

(b) Shitësi do të ketë përmbushur të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga marrëveshjet dhe angazhimet e nevojshme për t'u përmbushur prej tyre përpara, ose në Datën e Mbylljes;

(c) të gjitha autorizimet e nevojshme nga autoritetet shqiptare administrative, përfshirë Bankën e Shqipërisë si dhe autorizimet dhe miratimet e tjera të kërkuara nga legjislacioni shqiptar, për të ekzekutuar këtë transaksion, duhet të jenë marrë në mënyrën e duhur, jo në kushte të papërshtatshme, të cilat Blerësi do të refuzonte t'i pranonte ose me kusht që autoritetet shqiptare të mos kenë kundërshtuar transaksionin brenda kufijve kohorë ligjorë;

(d) të gjitha procedurat e Bankës si shoqëri që janë të nevojshme përsa i përket transaksionit të kësaj Kontrate duhet të kryhen në perputhje me ligjet e Shqipërisë;

4.1.2 Kushtet e listuara ne nen-nenet 4.1(a), 4.1(b), 4.1(c) jane ne perfitim te Bleresit, i cili mund te heqe dore nese deshiron, dhe ashtu sic e gjykon te arsyeshme (qofte dhe pjeserisht) nga permbushja e ketyre kushteve. Prej kushteve te listuara ne nen-nenet 4.1(d) mundet te hiqet dore vetem me marreveshje midis Shitesit dhe Bleresit.

5. ANGAZHIMET DERI NË MBYLLJE

5.1 Angazhimet e Shitësit për t'u përmbushur Përpara Mbylljes

5.1.1 Përpara Datës së Mbylljes, Shitësi:

sa më shpejt të jetë e mundur pas Datës së Nënshkrimit, do të ndërmarrë dhe do të bëjë të mundur që Banka të ndërmarrë të gjitha depozitimet dhe aplikimet e nevojshme, ose të kërkuara nga Shitësi, nëse do të ketë, në mënyrë që të realizohet blerja e Aksioneve në Datën e Mbylljes nga Blerësi siç parashikohet nga kjo Kontratë dhe do të japë dhe do të bëjë të mundur që Banka të japë të gjithë asistencën e mundshme Blerësit per te marrë lejet dhe miratimet e kërkuara sipas kësaj Kontrate.

5.2 Marrëveshje të Përbashkëta

5.2.1 Në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, Palët pranojnë të bashkëpunojnë dhe të përpiqen në më të mirën e tyre, që të ndërmarrin, apo të bëjnë të mundur të ndërmarrin të gjitha veprimet, të përshtatshme, apo të këshillueshme sipas ligjeve të zbatueshme për të përmbushur dhe të bëjnë efektive transaksionet, që parashikohen në këtë Kontratë.

5.2.2 Varësisht nga kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të përpiqen të pajisen me të gjitha lejet, miratimet e nevojshme ose të këshillueshme për të përmbushur dhe bërë efektive transaksionet që parashikohen në këtë Kontratë, duke cilësuar këtu që secila Palë do të këshillohet me Palën tjetër përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim për t'u pajisur me lejet dhe miratimet nga autoritetet qeverisëse shqiptare.

6. MBYLLJA

6.1 Data e Mbylljes

Mbyllja do të realizohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme shqiptare njezet e pesë (25) Ditë pas pageses se plote te Çmimit te Blerjes, ose në çdo datë që Blerësi dhe Shitësi mund të bien dakord me shkrim (pershire mjetet elektronike).

6.2 **Veprimet e Mbylljes**

Me nenshkrimin e kësaj kontrate, me përjashtim të rastit kur Shitësi dhe Blerësi bien dakord ndryshe me shkrim, veprimet e mëposhtme duhet të ndërmerren:

6.2.1 Përfaqësuesi i Shitësit (ne emer dhe per llogari te Shitesit) do te:
dorezoje Bleresit nje deklarate te Bankes te nenshkruar nga personat e saj te autorizuar per qellime te Nenit 10 te Statutit te Bankes: dhenia e pelqimit per transferimin e Aksioneve te Transaksionit, duke deklaruar qe Banka nuk ka asnje pretendim te asnje lloji mbi Aksionet dhe duke deklaruar qe banka do ta regjistroje transferimin e aksioneve ne Regjistrin e saj te Aksioneve.

6.2.2 Me përmbushjen nga Shitësi te dhenies se dokumentave të caktuara në Nenin 6.2.1, Bleresi duhet te depozitoje Çmimin e Blerjes ne Llogarine e percaktuar ne nen-nenin 2.2 (Çmimi i Blerjes) brenda 5 diteve pune nga Data e kesaj kontrate.

6.3 Mospërmbushja e Detyrimeve

Nëse në Datën e Mbylljes Shitësi ose Blerësi nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre sipas Nenit 6.2 (Veprimet për Mbylljen), Pala tjetër mund:

(a) të shtyjë afatin e Mbylljes në një datë jo më vonë se njëzetë e tetë (28) ditë pas Datës së Mbylljes (keshtu, dispozitat e Nenit 6.2 (Veprimet për Mbylljen), me përjashtim të kësaj pike, do të bëhen të zbatueshme për Datën e Mbylljes, e cila është shtyrë); ose

(b) të vazhdojë me Mbylljen përsa është e mundur (pa cënuar të drejtat sipas kesaj Kontrate), pasi të jetë përcaktuar që Mbyllja do të kryhet vetëm nëse Aksionet do t'i shiten Blerësit; ose

(c) të zgjidhë këtë Kontratë.

6.4 Veprimet Pas Mbylljes

Pasi Shitesi te kete marre Çmimin e Blerjes ne llogarine e percaktuar ne nen-nenin 2.2, Shitësi do të mundësojë që Banka të depozitojë kërkesën për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe Qendren e Regjistrimit te Aksioneve (QRA) për transferimin e Aksioneve te Transaksionit në Datën e Mbylljes ose nëse kjo nuk është e mundur, ditën tjetër pas Datës së Mbylljes kur keto institucione të jenë hapur.

7. DEKLARIMET DHE GARANTIMET E SHITËSIT

7.1 Te drejtat, Kompetencat, Autoriteti dhe Veprimet

Kjo Kontratë përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Shitësin, e zbatueshme ndaj Shitësit, në përputhje me kushtet e saj. Shitësi ka autoritetin dhe aftësinë për të nënshkruar, dorëzuar dhe për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate.

7.2 Shkeljet

Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja nga Shitësi i kësaj Kontrate dhe i detyrimeve që rrjedhin prej saj nuk do të jenë në kundërshtim me ndonjë ligj, rregullore, marrëveshje, vendim të gjykatës, kontrate apo kufizim tjetër, sipas të cilit Shitësi është i detyruar.

7.3 Transferimi i Aksioneve te Transaksionit

7.3.1 Shitësi është regjistruar si pronar i vetëm i Aksioneve dhe gëzon të drejtën të transferojë aksionet tek çdo person, apo shoqëri pa kufizim.

7.3.2 Aksionet janë të lira nga çdo barrë.

7.3.3 Të gjitha procedurat e nevojshme për të kryer transferimin e Aksioneve në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në Datën e Mbylljes janë zbatuar sic duhet nga Shitësi.

8. DEKLARIMET DHE GARANTIMET E BLERËSIT

Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin, që deklarimet dhe garantimet e mëposhtme janë të vërteta dhe të sakta në këtë datë dhe do të jenë të vërteta dhe të sakta deri në Datën e Mbylljes:

a. Blerësi është i organizuar dhe ekziston në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje të mirë,
b. Kjo Kontratë përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Blerësin, e zbatueshme për Blerësin, në përputhje me kushtet e saj. Blerësi ka autoritetin dhe aftësinë të nënshkruajë dhe dorëzojë këtë Kontratë dhe të permbushë detyrimet që burojnë prej saj.
c. nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nga Blerësi është autorizuar në mënyrën e duhur dhe të vlefshme nga të gjitha organet e nevojshme të Blerësit, në përputhje me dokumentet e tij kryesore dhe organike dhe nuk do të rezultojë në shkelje, apo mospërmbushje të ndonjë marrëveshjeje, apo vendimi gjyqësor ku Blerësi është palë, ose të cilat janë detyruese për Blerësin dhe ekzekutimi i të cilave do të ndikojë në mënyrë të pafavorshme në aftësinë e Blerësit për të përmbushur kushtet e kësaj Kontrate.
d. nënshkruesit e kësaj Kontrate në emër të Blerësit janë autorizuar në mënyrën e duhur për të nënshkruar këtë Kontratë në emër të Blerësit.
e. veprimet dhe kerkesat e Bleresit ne zbatim te kesaj Kontrate, nuk do te ndryshojne negativisht objektivat aktuale operacionale te Bankes te cilat bazohen ne parimet e Sheriatit.
f. Pavaresisht gjithckaje qe mund te jete e kundert ketu, me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Bleresi merr persiper te beje hetim dhe vleresim te pavarur te pershtatshmerise se ketij transaksioni; dhe te beje vleresimin e tij te pavarur, vleresimin e cilesise dhe hetimin e te gjitha rreziqeve qe rrjedhin apo lidhen qellimin e kesaj Kontrate.

9. KUSHTET E ZBATUESHME PËR GARANCITE

9.1 Kushte të Përgjithshme

9.1.1 Palët garantojne dhe deklarojnë se ato e lidhin këtë Kontratë duke u bazuar ne secilin prej Garancive

9.1.2 Secila prej Garancive do të jetë i veçantë dhe i pavarur dhe, përveç rastit kur parashikohet

shprehimisht, nuk do të kufizohet duke iu referuar Garancive të tjera, apo çfarëdo qoftë në këtë Kontratë.

9.2 Pretendimet për shkak te Garancive ose qe lidhen me to

9.2.1 Shitesi ketu angazhohet t'i paguaje Bleresit, ne baze te kerkeses, sipas zgjedhjes se Bleresit: 100% te Humbjeve te pesuara nga Bleresi dhe qe mund te rezultoje prej ndonje mos-perputhje, mosveprim ose pasaktesi ne lidhje me ndonje Garanci por jo me shume se Çmimi i Blerjes ne cdo rast.

9.2.2 Perveç rasteve te mashtrimeve, neglizhences se rende, sjelles se keqe te qellimshme ose fshehjes se qellimshme nga Shitesi, pergjegjesia e Shitesit ne lidhje me ndonje Humbje nen Garantimet do te kufizohet sic percaktohet ne kete klauzole 9 (Kushtet qe aplikohen per Garantimet):

a. Shitesi nuk do te jete pergjegjes per sa i perket ndonje Humbje nen Garantimet, nese nuk ka marre nga Bleresi dhe/ose Banka ndonje njoftim me shkrim ne perputhje me percaktimet e nen-klauzoles 9.4 (Njoftimi per Shitesin), qe jep detaje te arsyeshme te Humbjes perkatese (edhe nese eshte vetem pjesore) dhe perfshin, nese eshte e zbatueshme, vleresimin e shumes se Humbjes, mbi ose nga:

i. per sa i perket transferimit, pronesise dhe titullit ligjor te Aksioneve, perfundimin e parashkrimit shqiptar per titujt ligjor dhe transferimin e pronesise se Aksioneve;

b. Shitesi nuk do te jete pergjegjes per sa i perket ndonje Humbje nen Garantimet:

i. nese dhe ne masen qe kjo pergjegjesi lind ose rritet si rezultat i ndonje veprimi ose mosveprimi te Bleresit pas Mbylljes; ose

ii. nese dhe ne masen qe kjo pergjegjesi lind ose rritet si rezultat i ndonje ndryshimi nen IFRS qe do te kerkonte nje riklasifikim te pasqyrave financiare per ndonje periudhe deri ne Daten e Mbylljes, duke perfshire dhe kete date.

c. Shitesi nuk do te jete pergjegjes per sa i perket ndonje Humbje nen Garantimet, nese dhe ne masen qe Bleresi ose Banka kane te drejte te kerkojne ne lidhje me ndonje Humbje ose dëm te pesuar prej ndonjerit prej tyre qe lindin nga shkelja e Garantimeve sipas kushteve te ndonje police sigurimi ne kohen qe ka qene ne fuqi;

d. Shitesi nuk do te jete pergjegjes per sa i perket ndonje Humbje nen Garantimet, i cili, ne kohen qe Humbja i njoftohet Shitesit sipas parashikimeve ten en-klauzoles 9.2.2 (a), eshte vetem pjesor. Ne kete rast Shitesi nuk do te jete i detyruar per te kryer ndonje pagese ne lidhje me kete Humbje, nese kjo Humbje nuk behet aktuale brenda dymbedhjete (12) muajsh nga data e Njoftimit te Kerkeses.

9.3 Kufiri i Pergjegjesise

Pervec Humbjeve qe lindin ose lidhen me nen-nent 7.1 (Te drejtat, Kompetencat, Autoriteti dhe Veprimet) deri ne 7.3 (Transferimi i Aksioneve), dhe pavaresisht nen-nenit 9.2.2 (a)(i) dhe (ii), pergjegjesia e pergjithshme e Shitesit ne lidhje me ndonje Humbje nen Garantimet, nuk do te tejkaloje 5% te Cmimit te Blerjes sic percaktohet ne nen-klauzolen 2.2.1.

9.4 Jo Rikuperim i Dyfishte

Bleresi dhe/ose Banka nuk do te kete te drejte te rikuperoje demet ose te rimbursohet me shume se nje here per sa i perket te njejtes humbje.

9.5 Njoftimi per Shitesin

9.5.1 Nese merret ndonje vleresim ose Humbje (edhe nese pjesore), ose ndonje ceshtje ose rrethane vjen ne vemendje te Bleresit ose Bankes per te cilin Bleresi ose Banka eshte ne dijeni, Shitesi mund te jete pergjegjes nen Garantimet:

a. Bleresi do t'i jape njoftim te shkruar perfaqesuesit te Shitesit (per llogari te Shitesit) ose do te sjelle si pasoje qe Banka t'i jape njoftim me shkrim per kete perfaqesuesit te Shitesit (per llogari te Shitesit) brenda dyzet (40) Dite Pune nga marrja dijeni per te (**Njoftimi per Pretendimin),** nenkupton qe deshtimi per te njoftuar Bleresit brenda periudhes se lartpermendur nuk do te ndikoje tek detyrimet e Shitesit per te demshperblyer Bleresin dhe/ose Banken; dhe

b. Bleresi do t'i jape Perfaqesuesit te Shitesit (per llogari te Shitesit) informacionin e arsyeshem qe mund te kerkojne per ti mundesuar atyre per te hetuar kete Humbje dhe pergjegjesine e mundshme te tyre per sa i perket kesaj Humbje brenda oreve normale te punes.

9.5.2 Nese Perfaqesuesi i Shitesit (per llogari te Shitesit) kundershton Njoftimin per Kerkese, Palet do te tentojne te zgjidhin mosmarreveshjet e tyre ne menyre miqesore, dhe ne rast se nuk arrihet nje marreveshje brenda njezet (20) Dite Pune nga data e marrjes se Njoftimit per Kerkese, konflikti do te zgjidhet ne perputhje me parashikimet e klauzoles 13 te kesaj Kontrate.

9.5.3 Pagesat nen kete klauzole 9 (Kushtet qe i aplikohen Garantimeve) do te behen ne USD. [Shuma e Humbjes do te llogaritet ne Leke dhe do te konvertohet ne USD sipas Kursit te Kembimit.]

9.5.4 Pagesat nen kete klauzole 9 (Kushtet qe i aplikohen Garantimeve) do te konsiderohen nje zvogelim I Çmimit te Blerjes.

10. DISPOZITA TË NDRYSHME

10.1 Qëllimi i Detyrimeve

10.1.1 Shitësi angazhohet sipas kësaj Kontrate për veten e tij, si dhe për pasuesit e tij.

10.1.2 Kontrata do të vazhdojë në përfitim të pasuesve të Blerësit.

10.2 Konfidencialiteti

10.2.1 Asnjë nga Palët, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, nuk duhet t'i japë informacion asnjë personi dhe as të bëjë njoftim publik të informacionit në lidhje me ndonjë parashikim të kësaj Kontrate dhe/ose të transaksioneve.

10.2.2 Kur njëra nga Palët në mënyrë të arsyeshme përcakton se dhënia e informacionit, ose njoftimi sa më sipër kërkohet me ligj, ose rregullore, apo nga ndonjë autoritet tjetër, dhënia e informacionit, ose njoftimi do të bëhet për aq sa lejon ligji dhe pas konsultimit me Palën tjetër.

10.3 Tërësia e Kontratës dhe Ndryshimet

10.3.1 Kontrata dhe Shtojcat përbëjnë kontratën e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje tjetër më të hershme midis Palëve që lidhet me çështjen e kësaj Kontrate.

10.3.2 Çdo ndryshim në këtë Kontratë do të jetë i vlefshem vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ose për llogari të secilës Palë dhe në mënyrë të veçantë i referohet kësaj Kontrate.

10.4 Kostot

10.4.1 Secila Palë mbart kostot e saj lidhur me negociatat për lidhjen e kësaj Kontrate dhe Mbylljen e dokumenteve ligjore detyruese për shitjen dhe blerjen.

10.4.2 Çdo detyrim për transferimin, ose për taksën e pullës, që mund të rezultojë si rrjedhojë e nënshkrimit të Kontratës dhe transferimit të Aksioneve, do të mbulohen nga Blerësi.

10.5 Veçueshmëria

Në qoftë se në çdo kohë, ndonjë nga dispozitat e kësaj Kontrate bëhet e pavlefshme, ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet veçmas nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur, do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme, e cila të jetë sa më afër me qëllimin e Palëve të kësaj Kontrate dhe, ku të jetë e mundur, të mos ndikojë, ose të dëmtojë vlefshmërinë, ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Kontrate.

10.6 Tjetersimi

10.6.1 Kjo Kontrate do te jete e detyrueshme dhe do te hyje ne veprim per pasardhesit e Paleve, por nuk do te jete e tjetersueshme pa miratim paraprak me shkrim nga Palet e tjera.

10.6.2 Pavaresisht si me lartpermendur, Bleresi ka te drejte t'ia tjetersoje kete Kontrate nje kompanie tjeter te grupit te tij, kundrejt procedurave te aplikueshme.

10.7 Vazhdimësia e Kontratës pas Mbylljes

Garantimet dhe parashikimet e tjera të kësaj Kontrate, të cilat nuk janë zbatuar deri në Datën e Mbylljes do të mbeten në fuqi dhe efekt, pavarësisht Mbylljes.

10.8 Jo Partneritet ose Agjenci

Asgje ne kete Kontrate (apo ne ndonje nga marreveshjet e percaktuara ketu) nuk do te konsiderohet se perben nje partneritet ndermjet Paleve dhe, pervec kur shkruhet shprehimisht, nuk percakton ndonje Pale si agjentin e Pales tjeter per asnje qellim.

10.9 Të Drejtat dhe Çështje të tjera

10.9.1 Të drejtat, autoriteti, privilegjet dhe ndreqjet ligjore të parashikuara në këtë Kontratë janë të gjera dhe nuk janë të kufizuara në të drejtat, autoritetet, privilegjet, ose ndreqjet ligjore të cilat parashikohen nga ligji, apo ndryshe.

10.9.2 Asnjë dështim apo vonesë në ushtrimin e të drejtave, autoritetit, privilegjeve ose ndreqjeve ligjore sipas kësaj Kontrate nuk do të prekë apo të ndikojë në ndonjë mënyrë në ushtrimin e tyre dhe nuk do të përbëjë heqje dorë prej tyre në tërësi, ose pjesërisht.

10.9.3 Ushtrimi i vetëm, ose i pjesshëm i të drejtave, autoritetit, privilegjit, ose ndreqjeve ligjore sipas kësaj Kontrate, nuk do të ndalojë ushtrimin e mëtejshëm të të drejtave të tjera, autoritetit, privilegjit, ose ndreqjeve ligjore.

10.10 Sigurim i Mëtejshem

Në çdo kohë pas kësaj date, Shitësi, me kërkesën dhe shpenzimet e Blerësit, do të nënshkruajë, apo sigurojë nënshkrimin e këtyre dokumenteve dhe do të kryejë, ose sigurojë kryerjen e veprimeve, të cilat mund të kërkohen nga Blerësi me qëllim marrjen e të drejtave të pronësisë mbi Aksionet nga Blerësi dhe kalimin tek Blerësi të përfitimeve të plota, që burojnë nga të gjitha parashikimet e kësaj Kontrate.

10.11 Ndreqjet Ligjore

Palet njohin dhe pranojne se përsa u përket shkeljeve të Garantimeve, apo të parashikimeve të tjera të kësaj Kontrate, dëmshpërblimi do të jetë ndreqja e vetme.

10.12 Gjuha

Kjo Kontratë është hartuar në gjuhën angleze dhe është përkthyer në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhje versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

11. NJOFTIMET

11.1.1 Përvec rastit kur është pranuar ndryshe, të gjitha njoftimet dhe komunikimet për secilën Palë do të bëhen me shkrim në gjuhën angleze dhe do të: (i) dërgohen ose personalisht, ose (ii) me postë të regjistruar, ose (iii) me email, te cilat do te konsiderohen te marra pas 12 oresh, ose (iv) derguar me korrier në adresat si më poshtë, ose në ndonjë adresë tjetër të njoftuar me shkrim:

(a) Për Blerësin:

EUROSIG SH.A.
Ne vemendje te: z. Kadri MORINAJ
e-mail: kadrimorinaj@eurosig.al

(b) Për Shitësin:

Dallah Albaraka Holding Company BSC (c)
Ne vemendje te: z. Adil Dahlawi
e-mail/fax: Adil.dahlawi@dallah.com
Per dijeni: a.buhusain@dallah.com

11.1.2 Njoftimet do të konsiderohen të marra nga Pala, së cilës i është drejtuar: (i) ditën e dërgimit, nëse është dërguar personalisht, ose me korrier, ose (ii) në datën e treguar në faturën e konfirmimit të nënshkruar, për dërgesat me postë të regjistruar.

12. Ligji i Zbatueshëm Dhe Arbitrazhi

12.1 Ligji i Zbatueshëm

Përveç dispozitave të detyrueshme të ligjeve të Shqipërisë, kjo Kontratë do të udhëhiqet nga dhe do te interpretohet ne perputhje me ligjin e Dubai International Financial Center (DIFC).

12.1.1 Arbitrazhi

12.1.2 Palët pranojnë t'ia paraqesin për zgjidhje arbitrazhit çdo mosmarreveshje në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin, ose zbatimin e Kontratës.

12.1.3 Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me këtë Kontratë do të zgjidhen sipas Rregullave të Arbitrazhit të Qendres se Arbitrazhit DIFC-LCIA, Rregulla, të cilat konsiderohen te përfshirë duke iu referuar atyre në këtë Nen 12.1.2.

12.1.4 Selia e arbitrazhit do të jetë DIFC (Dubai, U.A.E).

12.2.4 Gjuha në të cilën do të zhvillohet procedura e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze dhe provat, si dhe memorandumi për arbitrat, do të relatohen në gjuhën angleze. Vendimi përfundimtar nga gjykata e arbitrazhit do të jepet në gjuhën angleze.

Unë, Noteri Publik, pasi u lexova me zë përmbajtjen e plotë të kësaj Kontrate Palëve, në praninë e përkthyeses së gjuhës angleze Arta Taipi, pranoj se Kontrata është në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, pasi u nënshkrua në praninë time, unë vërtetoj nënshkrimin sipas ligjit shqiptar. Kjo kontrate perbehet nga 19 faqe. Kontrata nenshkruhet ne 4 kopje, 2 per palet, nje per noterin dhe nje per Banken.

PALËT

Firmosur nga Xhevdet Kopani
Ne emer dhe per llogari te Bleresit

DIRK HOLLSTEIN

Firmosur nga Dirk Hollstein,
Ne emer dhe per llogari te Shitesit

Për këtheni: ARTA TAIPI

NOTER ERMAL XH.HAMZAJ

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Struktura e Kapitalit te BBSH-se **pas realizimit te kesaj Kontrate:**

Nr.	Emrat e Aksionereve	Numri I aksioneve	Kapitali i paguar ne USD	Kapitali i paguar ne Leke	Vlera per aksion	Perqindja e pjesemarrjes
1	Banka Islamike per Zhvillim - Islamic Development Bank	425,334	10,212,269	1,369,592,068	24.010	72.20%
2	EUROSIG SH.A.	**123,807**	**2,972,606**	398,663,368	24.010	**21.02%**
3	Ithmaar Bank	25,346	608,557	81,615,108	24.010	4.30%
4	Saudi Brothers Commercial Co.	3,168	76,064	10,201,084	24.010	0.54%
5	Hamed H. Mutabakani	9,306	223,437	29,965,683	24.010	1.58%
6	Hayder Mohamad Awad	1,267	30,421	4,079,789	24.010	0.22%
7	Faisal A. El Khereiji	842	20,216	2,711,273	24.010	0.14%
	T o t a l	**589,070**	**14,143,571**	**1,896,828,373.73**	**24.010**	**100.000%**

Shtojca 2. Vendimet nga organet kompetente vendimmarrese te Bleresit dhe Shitesit qe miratojne Kontraten.

EUROSIG
KOMPANI SIGURIMESH
Rr. Papa Gjon Pali II , Vila Nr. 5, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00355 4 2238999 /2238899 Fax: 00355 4 2223841 Cel: 00355 69 20 70 659 E -mail: info@eurosig.alWeb: www.eurosig.al

Nr 5884 Prot

Datë 28 / 10 /2020

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

VENDIM
Nr. 10 dt. 28/10/2020

PËR
BLERJEN E AKSIONEVE NË UBA BANK
(UNITED BANK OF ALBANIA- BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË)

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve e mbledhur sot në Tiranë,më datë 28/ 10 /2020,në orën 12:30,në selinë e shoqërisë "Eurosig"sha,me adresë Rruga "Papa Gjon Pali i II-të, Vila nr.5",Tiranë, në zbatim të neneve 135, 136, 144, 145 të ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, ligjit Nr 52/2014 *"Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"* të ndryshuar, në përfundim me unanimitet të plotë,

V E N D O S I :

1. Blerjen e 12,673 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) aksioneve që Dallah Albaraka Holding Company BSC zotëron pranë UBA- Shqipëri (Banka e Bashkuar e Shqipërisë), me një çmim total prej 266,133 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e tre) USD (dollar Amerikan).

2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "Eurosig" sha Shqipëri, Z. Xhevdet Kopani për ndjekjen e procedurave të nevojshme për nënshkrimin e marrëveshjes së blerjes së aksioneve si edhe ekzekutimin e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A K S I O N A R Ë T :

KADRI MORINAJ **YLLI MERKAJ** **XHEVDET MORINA**

SHOQËRIA"EURO-ALBANIA" SHPK
PËRFAQËSUAR NGA Z. GAZMEN NEZA

Banka e Bashkuar
e Shqiperise
United Bank
of Albania

Tirane, me 04 Dhjetor 2020

Ref: 315/ 20

DEKLARATE PELQIMI PER SHITJEN E AKSIONEVE

Banka e Bashkuar e Shqiperise SH.A., me seli ne Rrugen "Dritan Hoxha", Ndertesa nr. 11, Hyrja 3, Tirane, me License Bankare nr. 03 date 11.01.1999 dhe NIPT J91811004Q, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem Amel Kovacevic dhe Drejtori Ekzekutiv Ilir Çekiri, DEKLARON SI VIJON:

Banka e Bashkuar e Shqiperise SH.A. ka nje kapital te paguar prej 1,896,828,373.73 Leke i ndare ne 589,070 aksione me vlerë nominale 24.01 USD secili. Aksioneri **Dallah Albaraka Holding Company BSC** ka shprehur deshiren per t'ja shitur aksionet e tyre shoqerise EUROSIG SH.A. dhe pjesemarrja e tyre ne kapitalin e bankes eshte si vijon:

Emri i Aksionerit	Numri i Aksioneve	Perqindja e Pjesemarrjes	Kapitali Ne Leke	Kapitali ne US$
Dallah Albaraka Holding Co	12,673	2.151%	40,807,554.25	$ 304,278.73

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te bankes e ka miratuar kete transaksion ne mbledhjen e saj te dates 08 Shkurt 2020 pasi procedura eshte ndjekur dhe respektuar plotesisht ne perputhje te plote me Statutin e BBSH-se.

Per gjithe sa me lart, dhe per qellim te Nenit 10 te Statutit te BBSH-se, ne, Banka e Bashkuar e Shqiperise, deklarojme ketu se nuk kemi asnje pretendim te asnje lloji mbi aksionet e transaksionit, ato jane te lira, pa asnje kufizim dhe japim pelqimin per transferimin e aksioneve ne fjale.

Ne gjithashtu deklarojme se, kur Marreveshja per Shitjen e Aksioneve te jete ekzekutuar dhe bere efektive rregullisht, BBSH do ta regjistroje transferimin e aksioneve ne Regjistrin e saj te Çertifikatave te Aksioneve.

Per dhe ne emer te **BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE SH.A.**

UNITED BANK OF ALBANIA UBA TIRANA Head Office BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË

Ilir Çekiri
Drejtor Ekzekutiv

Amel Kovacevic
Drejtor i Pergjithshem

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh. A; KIB 203
Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Nd. 11, H.3 ,

Nr. i Licencës: 3 Dt. 11.01.99; NIPT J91811004Q
Swift: AAISALTR; E-mail info@ubaal.com Reuter: AAIB

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit:	D-20201209143143285
Data e Rezultatit te Kerkimit:	09.12.2020
Ora e Rezultatit te Kerkimit:	2:31:43PM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-113-1588
Referenca e Perdoruesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

DIRK HELMUT HOLLSTEIN
DALLAH ALBARAKA HOLDING COMPANY BSC

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NOTER ERMAL ZH. HAMZAJ TIRANË

Qendra e Regjistrimit të Aksioneve SH.A.
Adresa: Rr. "Puntorët e Rilindjes", Nr.13 - Tiranë
Kutia Postare: 7424
Tel: ++355 - 42 - 3344

Konfirmim Llogarie

Nr. Kërkesës: 2020111110 15

Data	November 11, 2020
Emri Aksionerit	DALLAH ALBARAKA HOLDING CO
Llogaria	DLLLBRE0990

Shoqëria Emetuese	SH.A. BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE - TIRANE
Kodi i Shoqërisë	99-088
Lloji i Aksionit	NOMINATIV (COMMON)
Vlera Nominale / Aksion	24.01 USD
Kapitali themeltar	14,143,570.7 USD

Aksione në Zotërim	12,673	dymbëdhjetëmijëegjashtëqindeshtatëdhjetëetr
Përqindja në K. Themeltar		2.151%
Aksione të Lira	12,673	dymbëdhjetëmijëegjashtëqindeshtatëdhjetëetr
Aksione të Bllokuara	0	zero

Punonjësi Arbon Fa...

Ky dokument duhet të ruhet në një vend te sigurtë. Ai duhet të përfshihet në korespondencën midis aksionerit dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve SH.A. Aksioneri mban përgjegjësi për humbjet e shkaktuara nga përdorimi i paautorizuar këtij dokumenti. Në bazë të Ligjit Nr. 8108, datë 28/03/1996 Qendra e Regjistrimit të Aksioneve është aktualisht i vetmi institucion i cili vërteton ligjërisht pronesinë mbi aksionet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ERMAL XH. HAMZAJ

PULLE TARIFE

V20200531501945241B4

DATE 09/12/2020
NR REP 5031

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 09/12/2020, para meje Noter ERMAL XH. HAMZAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Rruga: "Pashko Vasa", Pallati Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia Bashkiake Nr. 5, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:
Thodhori Kamberi, atësia Kristostom, amësia Amalina, shtetas Shqiptar, lindur në Athinë, Greqi (GRC) dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Gjergj Fishta; Nd. 30; H. 33; Ap. 16; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 18/06/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035071118 dhe nr. personal J10618107T , .

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.
Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.
Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ

ERMAL XH. HAMZAJ

No. 0 Rep.

TRANSLATION CONFIRMATION

NOTARY
ERMAL XH. HAMZAJ

ERMAL XH. HAMZAJ

APOSTILLE
(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Country: Pays / País:	Kingdom of Bahrain
This public document Le présent acte public / El presente documento público	
2. has been signed by a été signé par ha sido firmado por	Hassan Abdulla Alganami
3. acting in the capacity of agissant en qualité de quien actúa en calidad de	Ministry of Industry , Commerce and Tourism
4. bears the seal / stamp of est revêtu du sceau / timbre de y está revestido del sello / timbre de	Ministry of Industry , Commerce and Tourism

Certified
Attesté / Certificado

5. at à / en	Manama	**6. the** le / el día	15-October-2020
7. by par / por	Director of Consular Affairs - Ministry of Foreign Affairs		
8. Number sous no bajo el número	BHM183682		

9. Seal / stamp:
Sceau / timbre
Sello / timbre:

No:BHM183682
Date: 15/10/2020
This Apostille only certifies the authenticity of the signature and the capacity of the person who has signed the document from Ministry of Industry , Commerce and Tourism
This Apostille does not certify the content of the document for which it was issued.
629282

10. Signature:
Signature :
Firma:

This Apostille only certifies the authenticity of the signature and the capacity of the person who has signed the public document, and, where appropriate, the identity of the seal or stamp which the public document bears.

This Apostille does not certify the content of the document for which it was issued.

[This Apostille is not valid for use anywhere within the Kingdom of Bahrain where possible and relevant, the territories to which the Apostille Convention has been extended]
[To verify the issuance of this Apostille, scan the QR Code in the above sticker.]

Cette Apostille atteste uniquement la véracité de la signature, la qualité en laquelle le signataire de l'acte a agi et, le cas échéant, l'identité du sceau ou timbre dont cet acte public est revêtu.

Cette Apostille ne certifie pas le contenu de l'acte pour lequel elle a été émise.

[L'utilisation de cette Apostille n'est pas valable en Royaume de Bahreïn, des territoires où la Convention Apostille s'étend].
[Cette Apostille peut être vérifiée à l'adresse suivante Scannez le code QR dans la vignette

---

Esta Apostilla certifica únicamente la autenticidad de la firma, la calidad en que el signatario del documento haya actuado y, en su caso, la identidad del sello o timbre del que el documento público esté revestido.
Esta Apostilla no certifica el contenido del documento para el cual se expidió.

[No es válido el uso de esta Apostilla en Reino de Bahrein, los territorios a los cuales el Convenio sobre Apostilla se haya extendido].]

KINGDOM OF BAHRAIN

Ministry of Industry, Commerce and Tourism

مملكة البحرين

وزارة الصناعة والتجارة والسياحة

This Document is bounded with Apostille
No BHM153682 Dated 15/10/2020
629282

شهادة قيد السجل التجاري
Commercial Registration Certificate

The Registration Directorate at the Ministry of Industry, Commerce and Tourism certifies that the merchant's below details have been registered in accordance with Decree law No. (27) for the year 2015 of the Commercial Registration.

تشهد إدارة التسجيل بوزارة الصناعة والتجارة والسياحة بأنه قد تم قيد التاجر المسجلة بياناته أدناه وذلك وفقاً للمرسوم بقانون رقم (27) لسنة 2015 بشأن السجل التجاري.

Due Date	09/05/2021	تاريخ الاستحقاق	Registration Date	09/05/1990	تاريخ القيد	Registration No.	23200 - 1	رقم القيد
Group Name	DALLAH ALBARAKA HOLDING COMPANY B.S.C (CLOSED)				شركة دلة البركة القابضة ش.م.ب (مقفلة)			اسم المجموعة
Commercial Name	DALLAH ALBARAKA HOLDING COMPANY B.S.C (CLOSED)				شركة دلة البركة القابضة ش.م.ب (مقفلة)			الاسم التجاري
Registration Type	Bahrain Shareholding Company (Closed)				شركة مساهمة بحرينية مقفلة			نوع القيد
CR Status	ACTIVE				نشطة			حالة القيد
Commercial Address	P.O.BOX ص.ب	Area المنطقة	Block مجمع	Road طريق	Building مبنى	Flat/Shop No. شقة/محل		العنوان التجاري
		AL SEEF / السيف	428	2813	1006	151		

Activities	الأنشطة
Activities of holding companies	أنشطة الشركات القابضة

* This CR does not permit its holder to practice investment activities on behalf of others.

* هذا القيد لا يجيز لصاحبه بمزاولة نشاط استثمار أموال الغير.

إدارة التسجيل

Registration Directorate

Q.F. 409 Issue 0

Issued Date: 15/10/2020

ease post this certificate at a visible place.

Tel : +973 80001700 - www.sijilat.bh - www.moic.gov.bh

يرجى تثبيت هذه الشهادة في مكان بارز داخل المحل.

KINGDOM OF BAHRAIN
Ministry of Industry, Commerce and Tourism

مملكة البحرين
وزارة الصناعة والتجارة والسياحة

تشهد إدارة التسجيل بوزارة الصناعة والتجارة والسياحة بأن المنشأة التجارية المسماة :

(شركة دلة البركة القابضة ش.م.ب)مقفلة

مسجلة لديها كـ شركة مساهمة بحرينية مقفلة بتاريخ **09/05/1990**

بموجب القيد رقم **23200-1** في السجل التجاري ،

ويمكن الحصول على معلومات السجل التجاري المذكور عن طريق

نظام سجلات الإلكتروني

(www.sijilat.bh)

The Registration Directorate at the Ministry of Industry, Commerce and Tourism certifies that the commercial entity named:

DALLAH ALBARAKA HOLDING COMPANY B.S.C (CLOSED)

is a **Bahrain Shareholding Company (Closed)** registered on **09/05/1990**

under commercial registration No. **23200-1** .

commercial registration portal

(www.sijilat.bh)

إدارة التسجيل

Registration Directorate

15/10/2020

إن وزارة الصناعة والتجارة والسياحة غير مسؤولة عن محتويات هذه الوثيقة

The Ministry of Industry, Commerce and Tourism is not responsible for the contents of this document

APOSTILLE
(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Country:
Pays / País: Kingdom of Bahrain

This public document
Le présent acte public / El presente documento público

2. has been signed by
a été signé par
ha sido firmado por: Lulwa mohiedden bahlool

3. acting in the capacity of
agissant en qualité de
quien actúa en calidad de: Bahrain Chamber for Commerce & Industry

4. bears the seal / stamp of
est revêtu du sceau / timbre de
y está revestido del sello / timbre de: Bahrain Chamber for Commerce & Industry

Certified
Attesté / Certificado

5. at
à / en: Manama

6. the
le / el día: 25-October-2020

7. by
par / por: Director of Consular Affairs - Ministry of Foreign Affairs

8. Number
sous no
bajo el número: BHM184502

9. Seal / stamp:
Sceau / timbre
Sello / timbre:

No:BHM184502
Date: 25/10/2020
This Apostille only certifies the authenticity of the signature and the capacity of the person who has signed the document from
Bahrain Chamber for Commerce & Industry
This Apostille does not certify the content of the document for which it was issued.
630185

10. Signature:
Signature :
Firma:



This Apostille only certifies the authenticity of the signature and the capacity of the person who has signed the public document, and, where appropriate, the identity of the seal or stamp which the public document bears.

This Apostille does not certify the content of the document for which it was issued.

[This Apostille is not valid for use anywhere within the Kingdom of Bahrain where possible and relevant, the territories to which the Apostille Convention has been extended]
[To verify the issuance of this Apostille, scan the QR Code in the above sticker.]

Cette Apostille atteste uniquement la véracité de la signature, la qualité en laquelle le signataire de l'acte a agi et, le cas échéant, l'identité du sceau ou timbre dont cet acte public est revêtu.

Cette Apostille ne certifie pas le contenu de l'acte pour lequel elle a été émise.

[L'utilisation de cette Apostille n'est pas valable au Royaume de Bahreïn, des territoires où la Convention Apostille s'étend].]
[Cette Apostille peut être vérifiée à l'adresse suivante Scannez le code QR dans la vignette

---

Esta Apostilla certifica únicamente la autenticidad de la firma, la calidad en que el signatario del documento haya actuado y, en su caso, la identidad del sello o timbre del que el documento público esté revestido.
Esta Apostilla no certifica el contenido del documento para el cual se expidió.

[No es válido el uso de esta Apostilla en Reino de Bahrein, los territorios a los cuales el Convenio sobre Apostilla se haya extendido].]

شـــركة دلـــه البـــركـــة القـــابضـــة (ش.م.ب.م)

Dallah Albaraka Holding Co. (E.C.)

In the name of Allah, Most Gracious, Most Merciful

Minutes of the Meeting of the Board of Directors of

DALLAH ALBARAKA HOLDING COMPANY B.S.C (Closed)

